



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 98
Prishtinë, më 17.4.2024, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Hykmete Bajrami, Arta Bajralija, Bekim Arifi, Halil Thaçi, Mirlinda Tishukaj-Sadiku, Hajdar Beqa, Visar Korencia, Albana Bytyçi, Rashit Qalaj.

Munguan: Yllëza Hoti, Adem Hoxha.

Stafi mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj.

Pjesëmarrësit tjerë: Jehona Rexha, Shpëtim Kalludra, Besa Dodaj, Myrvete Gashi, Ardiana Miftari dhe Driada Thaçi, ZKA; Erona Retkoceri, praktikante në Kuvend.

Mbledhjen e kryesoi Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 26.3.2024 dhe 2.4.2024;
3. Shqyrtimi i raportit të auditimit të performancës: “Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale përmes përfshirjes së tyre në tregun e punës”;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 26.3.2024 dhe 2.4.2024

Procesverbalet u miratuan pa ndryshime.

3. Shqyrtimi i raportit të auditimit të performancës: “Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale përmes përfshirjes së tyre në tregun e punës”

Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit: Po fillojmë mbledhjen e sotme të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, por meqenëse sot është shpallur ditë zie, ku brenda 4 ditëve u vranë dy gra nga bashkëshortët e tyre, mbledhjen po e fillojmë me një minutë heshtje, në nderim të viktimave Erona Cokli dhe Xhulieta Ukelli.

Pika kryesore e rendit të ditës është shqyrtimi i raportit të auditimit të performancës: “Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale përmes përfshirjes së tyre në tregun e punës”. Prezent sot në mbledhje kemi znj. Jehona Rexhën, drejtoreshë në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës, gjithashtu prezent kemi ekipin e ZKA-së, të cilët e kanë kryer këtë auditim të performancës, i cili përfshin vitet 2019/23. I ftuar ka qenë edhe ministri i Bujqësisë, por për arsye të agjendës së ngjeshur nuk ka mundur të jetë prezent sot në mbledhjen e KMFP. Deputete raportuese është znj. Albana Bytyçi, tek e cila po e kaloj fjalën, për të bërë një përmbledhje të raportit të auditimit, pastaj do të hapim diskutimin për këtë raport, duke shfrytëzuar edhe prezencën e përfaqësueseve të Agjencisë së punësimit.

Albana Bytyçi: Faleminderit kryetare, përshëndetje për të gjithë! Së pari dua të shprehë ngushëllime për familjen, për rastin, i cili ndodhi në Pejë dhe shpresoj që këto raste të mos ndodhin më asnjëherë dhe uroj që Ministria e Drejtësisë dhe të sigurisë, të ndërmarrin masat e nevojshme, sepse kjo është gjendje alarmante. Raporti i auditimit të performancës, vlerësimi dhe ndikimi i politikave, programeve, masave që synojnë promovimin e përfshirjes së grave nga zonat rurale në tregun e punës, me fokus rritjen e pjesëmarrjes së tyre dhe identifikimin e mundësive për përmirësim. Ky auditim përfshin periudhën përgjatë viteve 2019/22. Auditimi është kryer në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencisë për Zhvillimin e Bizneseve, si dhe Agjencinë e Punësimit. Investimet në pasuritë publike me ekonomit bujqësore, përqendrohen në përkrahjen e investimeve në këta sektorë: pemë & perime, qumësht, mish, rrush dhe vezë. Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i biznesit mbështet një varg aktiviteteve bujqësore dhe jobujqësore, përmes sektorëve, siç janë: artizanalet, zhvillimi i turizmit rural, prodhimtaria, mjalti, rritja e shpezëve etj. Përzgjedhja e këtyre dy masave është bërë për faktin se përmes tyre, gratë fermere kanë përparësi në përfitimin e granteve investive. Ky auditim ka lidhje të drejtpërdrejtë me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të agjendës 2030 të Kombeve të Bashkuara, për zhvillim të qëndrueshëm, ku barazia gjinore është një prej temave qendrore të kësaj agjende. Rezultatet e auditimit tregojnë se ende nuk janë arritur rezultate të kënaqshme për fuqizimin e gruas dhe përfshirjen e grave nga zonat rurale në tregun e punës. Programet e zhvillimit rural, të parapara për fuqizimin e grave në tregun e punës dhe përcaktimi i masave afirmative për këtë qëllim, nuk kanë arritur të sigurojnë një përkrahje të barabartë për të dy gjinitë. Nuk ka një vlerësim sistematik institucional për menaxhim të projekteve në baza gjinore apo rreth arritjes së qëllimeve të programit të një perspektive. Kriteret e përzgjedhjes nuk sigurojnë përkrahjen e barazisë gjinore, kriteret socio-

ekonomike implikohen nga kriteret tjera, për shembull: aplikuesit nga masa 1, investimet në asete fizike dhe zhvillimi ekonomik, në të marrin pikët afirmative vetëm nëse janë pronarë të tokës për tre deri në pesë vitet e fundit, aplikuesit gra në masën 302/7 – diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve marrin pikët vetëm nëse dëshmojnë tre vite pronësi në bizneset e hapura. Kjo d.m.th. se pikët afirmative nuk kanë pasur ndikim në mbështetjen e drejtpërdrejtë të grave. Mospërfshirja e grave rreth informimit për programet e zhvillimit rural, edhe pse autoritetin menaxhues në bashkëpunim me agjencinë e zhvillimit të bujqësisë e marrin të gjitha veprimet e nevojshme për informimin e fermerëve, mbajtjen e sesioneve informuese për programin e zhvillimit rurale. Numri i pjesëmarrësve nuk është i kënaqshëm, posaçërisht i grave. Pjesëmarrja e ulët e grave mund të ketë ndodhur si shkak, sepse sesionet informuese mbahen vetëm gjatë periudhës kur bëhet shpallja e thirrjeve për aplikim dhe nuk mbahen takime të rregullta. Në raportin e ZKA-së janë hasur mangësi në procesin e monitorimit të programit për zhvillim rural. Raporti i monitorimit përmban edhe analiza të tjera të tregueseve të performancës, cilësisë së zbatimit të projekteve të zhvillimit rural, ku janë paraqitur të dhëna për indikatorin e vendeve të reja të punës. Mirëpo, as vlerësimi i këtij indikator nuk është i ndarë sipas gjinisë. Janë bërë vonesa në shpalljet e thirrjeve për aplikim, në mospërputhje me punët sezonale apo në përshtatje me kushtet klimatike. Këto vonesa kanë ndodhur për shkak se procesi i aprovimit të programit për zhvillim rural zgjat prej 3 deri në 8 muaj. Vetëm programi i vitit 2019 është hartuar me kohë, ndërsa periudha e viteve 2020/23, këto programe janë hartuar dhe aprovuar me vonesë. Procedurat e shqyrtimit të aplikimeve nuk e përkrahin mjaftueshëm gjininë femërore. Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, gjatë regjistrimit të aplikuesve në sistem, bën vetëm një regjistrim të përgjithshëm të tyre. Sa i përket aspektit gjinor, OBSH-ja posedon të dhëna vetëm sa është numri i përfituesve sipas gjinisë dhe jo i aplikuesve. Procedurat e shqyrtimit të aplikacioneve janë jofavorizuese për barazinë gjinore. Refuzimi i kandidateve ndodh për arsye teknike të mospërputhjeve të shumave të planit të biznesit apo mosplotësimit të formularit në mënyrën e duhur. Në rastet kur kandidatet gra i plotësojnë kriteret e përzgjedhjes, por kanë pikë të barabarta me kandidatët tjerë, përsëri i nënshtrohen rrezikut që të refuzohen, për shkak të seleksionimit të bërë nga sistemi elektronik i bazuar në kohën kur aplikuesit kanë postuar aplikacionin. Gjatë periudhës audituese, numri i të interesuarave që i përkisnin gjinisë femërore, për grantet e masës, investimet në pasuritë fizike në ekonominë bujqësore ka qenë vazhdimisht në rritje. Mirëpo, edhe përkundër rritjes së numrit të aplikuesëve, niveli i përfituesve nga gjinia femërore ka pësuar rënie. Shkaktar i këtij zhvillimi joproporcional në mes të aplikuesve dhe përfituesve ka qenë kushtëzimi në mes pronësisë, moshën e fermerit dhe masat të tjera të ndërmarra në kriteret menjëherë pas vitit 2019. Për përmirësimin e këtij procesi janë dhënë 10 rekomandime, ku 8 prej tyre për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe 2 rekomandime tjera për Ministrinë e Financave, Punës dhe Transferve dhe Agjencinë e Punësimit. Ky ishte një raport i shkurtër me disa të gjetura dhe pak përkrahje të grave, kam kërkuar nga ministri i Bujqësisë, një mënyrë lehtësimi për fitimin e granteve nga gratë në zonat rurale, por nuk ka qenë e arsyeshme nga ana e tij, edhe pse thirren se janë të gatshëm për ndihmë, në këtë aspekt, këtu po shfaqet e kundërta.

Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit: Faleminderit deputetja znj. Albana për këtë përmbledhje. Të ftuar kanë qenë edhe Agjencia për Zhvillim Bujqësor, ku edhe gjetjet e auditimit kanë të bëjnë kryesisht me ta. Ajo se çfarë më ka bërë përshtypje rreth këtij raporti është vetë titulli: “Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale përmes përfshirjes

së tyre në tregun e punës. ZKA-ja duhej të shihte dhe sektorë të tjerë, sepse ka mjaft gra në zonat rurale të cilat janë të arsimuara, të edukuara dhe kanë potencial edhe për sektorë tjerë të punës, nuk është e thënë se vetëm pse janë në zonat rurale, të merren vetëm me aktivitete bujqësore. A janë përfshirë vetëm grantet apo edhe subvencionet, sepse flitet në mënyrë ekskluzive vetëm për grantet. Në raport me përqindjet dhe figurat, duhet të them se janë disa gabime, ku në f. 4 janë paraqitur treguesit e fuqisë punëtore sipas gjinisë në Kosovë, për periudhën 4- vjeçare 2019-22, ku thuhet se në vitin 2019, (80.5%) e grave si fuqi punëtore janë jo aktive, (31%) janë të papunë dhe (13%) janë të punësuar. Në total parqet shifrën 125%. E njëjta qëndron edhe tek analiza për gjininë mashkullore dhe do të ishte mirë që këto të dhëna të përmirësohen, sepse tregon një pasaktësi të shifrave. Ajo që është shqetësuese në tregun e punës është inaktiviteti. Gratë në Kosovë të cilat nuk kërkojnë punë, ne duhet të kemi një strategji kombëtare në këtë drejtim, që këto gra të jenë në kërkim të punës. Në f. 5 të raportit, tabela nr. 1 tregon se nga viti 2019 deri në vitin 2022, kemi një rënie të granteve nga Agjencia e Zhvillimit Bujqësor, ku përderisa përfitueseve të gjinisë femërore nga viti 2019 kanë qenë (43%), 2020/21 janë (37%) dhe 2022 janë (29%). Kur është fjala te përfitimet e granteve bujqësore, nëse bëjmë krahasimin me të dhënat e përgjithshme në tregun e punës, del se qëndrojnë pak më mirë se mesatarja e përgjithshme e grave në tregun e punës, ku prej 495 aplikanteve përfitues janë 145 gra, gjatë vitit 2022. Sa i përket kriterëve afirmative nga ZKA –ja, dua ta di nëse këto kriterë po ndihmojnë në fitimin e granteve për aplikuesit e gjinisë femërore. Maksimumi i pikëve ishte 88% dhe vetëm 2 pikë ishin kriter afirmativ. Për shkak të kriterëve afirmative, ne kemi raste ku në zona rurale pronësia e tokës kalon në pronësi të grave. A janë me të vërtetë pronare apo është vetëm lloj i përfitimit nga masat e diskriminimit pozitiv? A është ky kriter afirmativ, i cili ka rol në përfitimin e granteve dhe a janë vërtet këto gra pronare të tokave në zonat rurale? Gjithashtu kriteri që pronari duhet ta ketë pasur në pronësi tokën, më së paku 3-5 vite është i paarsyeshëm, sepse nuk është e nevojshme të ketë një histori të pronësisë. Kjo çështje duhet të merret parasysh, sepse këto kriterë nuk kanë impakte. Fjalën e kaloj tek auditorja.

Myrvete Gashi: Të nderuar pjesëmarrës! Fillimisht shpreh ngushëllime për rastet e dhunës në familje. Sa i përket auditimit, barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale, përmes përfshirjes së tyre në tregun e punës, është një auditimit paralel dhe jemi dakorduar për objektivat e përbashkëta dhe për të bërë krahasime me shtetet e rajonit, Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Arsyeja e përzgjedhjes së Ministrisë së Bujqësisë është sepse ka pasur programe për zhvillimin e bujqësisë për gratë në zonat rurale. Në nivelin lokal nuk jemi lëshuar, për shkak të kohës për kryerjen e auditimit, por kjo nuk do të thotë që në të ardhmen nuk do të mbulojmë komunat për përfshirjen e grave në tregun e punës. Dy masat kryesore të cilat i kemi mbuluar janë: investimet në pasurit fizike dhe diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i biznesit. Sa i përket të dhënat në përqindje, i kemi marrë nga ASK-ja, dhe nuk kanë hyrë në kuadër të të gjeturave nga ana e ZKA-së. Masat aktuale afirmative nuk janë efektive për të mbështetur gratë në zonat rurale. Sa i përket pronësisë së certifikatës, pronësia e tokës i kalon gruas, e cila është kusht për vlerësim.

Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit: Faleminderit auditorë! Ne presim nga ZKA-ja, që t'i gjejë gabimet nga të tjerët dhe jo të merren të dhënat, ashtu siç janë dhe të transmetohen në ndonjë raport tjetër. Nuk mund të thirremi në statistika të gabueshme. Fjalën e kaloj te znj. Jehona Rexha, drejtoreshë në Agjencinë për Punësim.

Jehona Rexha: Faleminderit kryetare, të nderuar deputetë dhe ju të pranishëm! Bazuar në gjetjet e auditorit, ne kemi dy rekomandime që është regjistrimi i punëkërkueseve dhe shërbimit të arsimit profesional, të ndara në zona urbane dhe rurale. Si agjenci, do të fokusohemi në aftësimin profesional në sektorin e bujqësisë, sepse kushtet i kemi me prioritet, e kemi mbulimin e transportit për trajnimet e punëkërkueseve për aftësim profesional.

Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit: E nderuar, sipas statistikave, të cilat i keni ju si agjenci, sa është përqindja e grave të papuna sot? Sepse, Agjencia e Statistikave të Kosovës, gratë e papunësuarat i konsideron ato gra, të cilat janë të lajmëruara tek Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës.

Shpëtim Kalludra: Deri në fund të vitit 2023, kemi pasur 41.773 punëkërkuës të regjistruar, ku prej gjinisë femërore janë 20.284 ose 40.2% të regjistruara.

Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit: Në raport me numrin e grave në Kosovë, sa është përqindja e grave të papuna?

Shpëtim Kalludra: Forca joaktive është shumë e madhe, diku 57%. Ne si agjenci, iu përgjigjemi të gjithë punëkërkueseve, të cilët regjistrohen në Agjencinë e Punësimit. Prioritet për Agjencinë e Punësimit janë gratë në tregun e punës, 63% e grave kanë përfituar në tregun e punës, duhet sigurisht të shikohen kriteret e punësimit për pozita të caktuara. Nëse flasim te punësimi i përgjithshëm, pjesëmarrja e punësimit të gjinisë femërore është e ulët, në raport me gjininë mashkullore.

Mirlinda Tishukaj-Sadiku: Faleminderit kryetare! I bashkëngjitëm deklarinë të vrasjes së këtyre zonjave dhe motrave tona, është situatë mjaft shqetësuese. Si politikbërës nuk kemi qenë në krye të detyrës edhe kur ka qenë Komisioni për Hetim Parlamentar për dhunën në familje. Falënderojmë ZKA-në për këtë auditim. Anketa “UN Woman”, a është konsultuar me ZKA-në në lidhje me mostart e marra? Për arsye se përqindjen e mostrës, më së shumti ka nga Prishtina dhe Prizreni, mirëpo në aspektin bujqësor janë disa komuna të cilat prijnë. Kemi shembull zonjat e Krushës së Madhe në Rahovec, të cilat eksportojnë dhe në masë të madhe punojnë në aspektin e bujqësisë, si dhe komunat tjera si Podujeva, Lipjani etj. Ju z. Shpëtim Kalludra e përmendët rritjen në përqindje, znj. Jehona Rexha përmendi tri masat e qeverisë, të cilat janë targetuar për herë të parë. A kanë ndikuar këto masat e qeverisë Kurti në rritjen e përqindjes së grave në tregun e punës? Ne e dimë se ka pasur thirrje dhe në subvencionim të pagës për ato biznese të cilat punësojnë gra, dhe mbështetje nga KIES-a. Pse nuk janë trajtuar grantet që janë ofruar nga KIES-a, ku znj. Hajdari e ka konfirmuar në Komision, që 40% të përfitueseve kanë qenë gra. Kjo pyetje i drejtohet ZKA-së. Agjencia për Punësim ka shërbime punësimi dhe aftësim profesional. Ne kemi pasur në trajtim raportin e auditimit me ndërlidhjen e tregut të punës me drejtimet të cilat janë në shkollat profesionale. ZKA-ja ka rekomanduar se nuk ka ndërlidhje në mes këtyre dy të fundit. A e keni analizuar këtë perspektivë, ju si Agjenci e Punësimit? Janë vetëm 7 qendra të aftësimin profesional, në Kosovë janë 63 shkollat të arsimit profesional. Sa është mundësia e bashkëpunimit për t’iu ofruar një lehtësi në transport për ato gra të cilat dëshirojnë të aftësohen për tregun e punës?

Jehona Rexha: Ne kemi bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në bazë të grupeve punuese të dokumenteve të hartuara. Qendrat e aftësisimit profesional janë të dedikuara për arsimin e të rriturve dhe atyre kandidatëve që regjistrohen si punëkërkuar, ndërkaq shkollat profesionale ende nuk kanë filluar me kurse të shkurtra 3-6 muajsh, të cilat mundemi t'i shfrytëzojmë edhe hapësirat e shkollave.

Mirlinda Tishukaj-Sadiku: Po nisem nga praktika, të cilën e kemi në Komunën e Vitisë, ku kemi shfrytëzuar shkollën e mesme profesionale për trajnim të një grupi të caktuar të grave, të cilat kanë përfituar në këtë rast nga Fondacioni Kosovë-Luksemburg, madje kanë fituar pajisje dhe trajnime. Të njëjtën praktikë mund ta bëjë edhe shteti dhe jo vetëm nga organizatat joqeveritare, të cilat vijnë nga jashtë.

Shpëtim Kalludra: Sa i përket përfituesve, ka rritje, sepse ka buxhet më shumë në krahasim me vitet e mëparshme. Përmes qendrave të aftësisimit profesional, ne mundohemi t'i kualifikojmë këta të rinj për tregun e punës.

Mirlinda Tishukaj-Sadiku: Një kërkesë shumë e madhe e punës është për sektorin IT-së, a po organizohen trajnime për këtë sektor, sepse kërkesat janë të mëdha?

Shpëtim Kalludra: Këtë vit, për herë të parë, me mbështetje të donatorëve kemi përdorur një instrument të ri përmes valcerëve, ku janë ofruar programe specifike nga sektori privat nga fusha e IT-së, kanë ofruar trajnime për të interesuarit përmes këtyre shkathtësive. Planifikojmë sigurisht në avancimin e programeve të tjera.

Albana Bytyçi: Për gratë fermere është shumë e rëndësishme mbajtja e trajnimeve, por shpenzimet e hequra nga Agjencia e Punësimit, në të cilën përfshihen vetëm një shujtë ushqimore ditore dhe transporti, janë shumë të pakta. Gratë fermere të Komunës së Suharekës e kanë të pamundur mbajtjen e trajnimeve, për shkak të shpenzimeve. A është e mundur rritja e kapacitetit për mbulimin e shpenzimeve apo dhënia e mëditjeve për gratë fermere?

Jehona Rexha: Atë se çfarë unë e theksova në rregulloren e masave aktive, është i paraparë mbulimi i transportit për gratë e papuna, të cilat ndjekin trajnime të aftësisimit profesional dhe është një shujtë ditore dhe një udhëtim, duke konsideruar përfitimet që në fund marrin, duke u pajisur me certifikatë për aftësim profesional.

Hajdar Beqa: Faleminderit kryetare, përshëndetje për ju të pranishëm! Realisht, ky është një auditim i cili tregon një pasqyrim të gjendjes, edhe pse ka mungesë të institucioneve tjera, Ministria e Bujqësisë dhe Agjencia për Zhvillim të Bizneseve, për një pasqyrim sa më real të gjendjes. Mosprezenca e aktorëve institucionalë, për të cilët edhe është bërë raport, nuk e arrin qëllimin e mbledhjes së sotme të Komisionit. Fillimisht, shpreh ngushëllime për familjet në Pejë dhe Ferizaj, në të njëjtën kohë, ne duhet ta pranojmë se jemi duke dështuar si shtet për parandalimin e këtyre dukurive, pavarësisht qeverisjes së mëhershme, të tanishme apo të ardhshme. Mungesa e një strategjisë kombëtare për përkrahjen reale të gruas dhe mos-pavarësia ekonomike e gruas, na shpie deri te këto konflikte në dhunën në familje. Sa i përket pritshmërive të granteve, a keni ju si Agjenci e Punësimit, ndonjë raport përmbyllës rreth arritjes së qëllimit për grantet përfituese nga gratë? Gjatë periudhës 2019/22, në bazë të raportit, është rritur numri aplikuesve gra, por

është ulur numri i përfitueseve, për shkak të kriterëve të cilat janë të paarsyeshme. Ne duhet t'i eliminojmë këto situata. A ka ndonjë strategji konkrete dhe kontroll mbi lehtësimin dhe zbatimin e këtyre kriterëve dhe procedurës në përfitimin e granteve?

Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit: Faleminderit deputet z. Beqa, fjalën e kaloj tek auditorja dhe pastaj deputeti z. Korenica.

Myrvete Gashi: Ne kemi pasur mbështetje nga "UN Woman", në veçanti për barazinë gjinore. Për këtë auditim kemi pasur mbështetje nga një eksperte nga Universiteti i Prishtinës, përgjatë gjithë auditimit. E angazhuar për këtë auditim ka qenë edhe një kompani për zhvillimin e anketës për pyetjet që ne na interesojnë. Sa i përket mostrës, është marrë në bazë të numrit të popullsisë në të gjitha komunitat.

Visar Korenica: Faleminderit kryetare, përshëndetje për të gjithë ju të pranishëm! Të gjeturat janë interesante dhe ndihmojnë shumë për auditimet e ardhshme që mund të bëhen në institucionet tjera. Në bazë të raportit, po shihet një rënie e grave përfituese, nga viti 2019 deri 2022, në zonat rurale dhe duhet të kemi ndonjë arsye për këtë çështje. Ju si Agjenci e Punësimit, a i shkëmbeni këto të dhëna në mënyrë të menjëhershme, ku mund të kemi një reagim adekuat për përmirësimin e situatës për përfshirjen përfituesve të granteve nga gratë në zonat rurale?

Shpëtim Kalludra: Agjencia e Punësimit, sistemin informativ e ka të ndërlidhur me regjistrin civil, ATK-në dhe Agjencinë për Regjistrim të Bizneseve, si dhe me disa institucione tjera publike. Na mungon ndërlidhja me Ministrinë e Bujqësisë dhe agjencitë përkatëse të kësaj ministrie. Në vitet e ardhshme do të raportojmë numrin e përfituesve në zonat rurale dhe urbane. Ne si Agjenci e Punësimit, vitin e kaluar, kemi dhënë diku rreth 34 grante në bashkëpunim me një projekt gjerman. Prioritet tona janë të shumta. Nga ky raport i auditimit do të marrim masa për përmirësim të mëtutjeshëm. Do marrim masa në shkëmbimin e informacioneve me institucionet relevante, të cilat gjenerojnë punësim.

Visar Korenica: Informacionet kthyesë tek institucionet përkatëse janë shumë të rëndësishme. Në mënyrë që të atakohet hendeku ku ka mungesë të zhvillimit profesional të dy gjinive. Kemi mungesë të përfituesve të granteve në fusha të caktuara, ku flasim për fusha të caktuara në tregun e punës dhe kërkesat të cilat janë për ata që kërkojnë punë, është në disproporcion. Për ne është e rëndësishme 'feedback'-u nga institucionet për marrjen e masave për përmirësimin e këtij raporti dhe sigurisht gjendjes aktuale. A keni ju, si agjenci, ndonjë raportim për masat që ju keni ndërmarrë, informacionet të cilat i keni përcjellë tek institucionet përkatëse dhe a ka pasur reagim ndaj tyre për masat e marra për përmirësim?

Shpëtim Kalludra: Ne si Agjenci e Punësimit, çdo vit, publikojmë një raport të performancës së punësimit dhe të aftësisimit profesional, që praktikisht e gjithë puna e agjencisë paraqitet në atë raport. Ky raport ka shumë indikatorë në përmirësimin e politikbërjes dhe për ndryshimet në grupet e ndryshme punuese.

Visar Korenica: Statistikisht, numri i grave të cilat kanë aplikur për grante në zonat rurale, nëse e krahasojmë periudhën 2019 dhe 2022, është pothuajse i njëjtë dhe nuk ka ndonjë diferencë të madhe, megjithatë ka një zbritje në përfitimin e këtyre granteve nga gjinia

femërore. Ne duhet të dimë përse është kjo zbritje në përfitimin e granteve, sepse duhet bërë ndërhyrje që të ketë ngritje në përfitimin e granteve nga gratë dhe jo zbritje të saj. Duhet të shikohet avancimi në sektor, ku ka mungesë të tregut të punës, për punëdhënësit të cilët kërkojnë punëtorë të aftë për pozita të caktuara. Sa i përket çështjes së IT-së, fusha STAMP, si qeveri ka pas sukses. Nëse shohim në UP, kemi 50% përfitues të studentëve që janë të gjinisë femërore dhe ka pasur përmirësim në këtë sektor. Atakimi i drejtpërdrejtë në fushën ku ka nevojë ka duke ndukur në përmirësimin e çështjes me masat adekuate.

Shpëtim Kalludra: Ne kemi ndërmarrë hapa, pas publikimit të këtij raporti të auditimit. Agjencia e Punësimit, në rregulloren e masës aktive është në harmoni me masat aktive, të cilat i ka Bashkimi Evropian. Kur flasim për dhënien e granteve, ku ka institucione tjera të cilat kanë buxhet më të madh në dhënien e granteve. Aty ku ka nevojë për përmirësim, ne jemi për të ndërhyrë me masat adekuate.

Visar Korenica: Unë konsideroj që ministrinë dhe agjencinë, duhet të kenë qasje proaktive në problemet e ndryshme, me të cilat përballen, nuk duhet të presim që njerëzit të paraqiten si punëkërkuar, por ne të shkojmë tek ata persona që nuk kërkojnë punë dhe t'i pyesim për arsyen se përse nuk kërkojnë punë, ndoshta kanë nevojë për aftësim profesional, hapësirë për kyçje në tregun e punës dhe t'i bëjmë të pavarur ekonomikisht. Të kemi një reagim proaktiv, në këtë aspekt.

Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit: Në faqen tuaj, në rrjetin social "Facebook" shoh se Agjencia për Punësim në Republikën e Kosovës ka diku rreth 381 ndjekës, dhe një portal pune në Kosovë ka 172 mijë ndjekës. Ajo që deputeti z. Korenica potencoi, është se ne na duhet proaktivitet. Numri i njerëzve që kërkojnë punë, është shumë më i madh se numri i njerëzve që lajmërohen në Agjencinë për Punësim. Informacioni nuk po shpërndahet te popullata rreth punës që bën Agjencia e Punësimit dhe përftimit që njerëzit mund të marrin, nëse regjistrohen në Agjencinë për Punësim. Pra, duhet të punohet në këtë drejtim. Një rekomandim, të cilin e kam, është trajnimi i të dy gjinive fermerë, të cilët duan të aplikojnë për grante, sepse janë procedura të komplikuar. Numri i aplikacioneve të refuzuara është çështje teknike. Mungesa e ndërlidhjes me sektorin privat dhe Agjencinë e Punësimit, është e dukshme, pasi që ka shumë fusha profesionale. Shembull, drejtimi për integrim evropian, ku sektorit privat nuk i duhet për tregun e punës. Ajo se çfarë na mungon është orientimi në karrierë. Pra, është mirë të bëhet një hulumtim i tregut të punës dhe të kemi statistikë se për çfarë ka nevojë më shumë tregu i punës. Masat aktive të tregut të punës, duhet të shohim nëse kemi qëndrueshmëri dhe mekanizma të kontrollit, mund të kemi në kontroll parane publike në efektivitetin e këtyre masave.

Jehona Rexha: Ne si Agjenci e Punësimit, fillimisht i trajnojmë dhe së bashku me trajnerin e përpilojmë një plan të biznesit për grantet që i japim ne si Agjenci e Punësimit. Pajtohem se kemi pasur problem në informimin e duhur për Agjencinë e Punësimit, e kemi me prioritet promovimin e shërbimeve të agjencisë. Një prej detyrave të këshilltarit të punësimit, është orientimi në karrierë i kandidatëve, të cilët vijnë në zyrat e punësimit.

Mirlinda Tishukaj-Sadiku: Organizohen shumë panairë të punësimit, cili është roli juaj aktiv, që të informohen me këta punëkërkuar, në mënyrë që të përfitojnë nga panairi i punës?

Jehona Rexha: Ne jemi pjesë e organizimit të shumë panairove dhe sigurisht që bëjmë promovimin e agjencisë për shërbimet që ofrohen.

Hajdar Beqa: Nëse marrim në përqindje grantet të cilat shpallen nga Agjenci e Punësimit, nuk e mbulon tregun as 3%, sepse grantet kryesore shpallen nga ministritë e tjera dhe të cilat kanë agjencitë përkatëse. Mendoj se duhet të ketë një kontroll dhe përcjellje të situatës se kush janë përfitues dhe në realizim të planit. Ministritë ose komunat, grantet i kanë nga mjetet e tatimpaguesve dhe është mirë të bëhet kontroll se sa po arrihet qëllimi. Numri i aplikuesve është rritur, por numri i përfituesve ka zbritur. Duhet të merren masa për përmirësimin e gjendjes.

Shpëtim Kalludra: Brenda vitit ka ndryshime në tregun e punës dhe është dinamik. Ajo që është me rëndësi në Agjencinë e Punësimit, është se personi apo punëkërkuksi, i cili regjistrohet në agjenci, ne bëjmë profilizimin e tyre dhe pastaj ne u japim këshillime në punësim, karrierë, aftësim profesional etj. Kriteret janë pika mbështetëse për aplikuesit e granteve.

Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit: Ju faleminderit për diskutimin, Agjencisë për Punësim e Republikës së Kosovës dhe ZKA-në, nëse nuk ka pyetje të tjera, po e përfundojmë diskutimin. Duke pasur parasysh se deputetja raportuese, Albana Bytyçi shkoi, adresimin e këtij raporti do ta vendosim në mbledhjen e radhës.

4. Të ndryshme

Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit: Në këtë pikë, Komisioni duhet të vendosë, nëse raporti i auditimit të performancës: “Efektiviteti i programit për trajtimin e pacientëve jashtë institucioneve shëndetësore publike”, do të adresohet për në seancë plenare, bashkë me rekomandimet e propozuara nga Komisioni, apo do të mbetet në nivel të Komisionit. Ata kanë qenë prezent dhe besoj që kemi diskutuar krejt çka kemi dashur.

Hajdar Beqa: Ky raport dhe këto çështje janë të ndjeshme për qytetarët e vendit, andaj konsideroj se është në interes të opinionit publik për diskutimin e këtij raporti, në mënyrë që kjo të ndikojë në përmirësimin e gjendjes. Ka përmirësime, por kemi edhe plot raste kur pacientëve ju vonohen mjetet dhe familjarët po përballen me vështirësi.

Arta Bajralija: Personalisht, nuk mendoj se duhet të dërgohet në seancë, sepse kemi pasur ministrin prezent I kemi marrë gjitha përgjigjet, po ashtu takimi ka qenë i transmetuar, i hapur, andaj edhe në seancë nuk është që bëhet ndonjë punë më e madhe, përveçse diskutimi po merr kahe politike dhe ky raport nuk ka nevojë për një diskutim të tillë.

Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit: Po, në fakt ne e patëm në takim ministrin e Shëndetësisë dhe drejtorin e Fondit. E kam edhe një hall, se pikat e komisionit tonë po i vendosin në fund dhe asnjëherë nuk po trajtohen si duhet në seancë. Andaj, për të diskutuar për këtë fond, do të ishte më e udhës ta ftojmë një debat parlamentar, sesa të ndalemi me këtë raport.

Hajdar Beqa: Duke u bazuar në praktikat e Komisionit, atëherë po gjejmë një konsensus dhe po e përkrah raportuesen.

Përfundim

KMFP, me pajtueshmërinë e të gjithë deputetëve prezentë, vendosi që raporti i auditimit të performancës: “Efektiviteti i programit për trajtimin e pacientëve jashtë institucioneve shëndetësore publike”, të mos adresohet për në seancë.

Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit: Ju faleminderit të gjithëve!

Për takimin e radhës do të njoftoheni me kohë.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Hykmete Bajrami,

Kryetare e Komisionit